



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.68/2019
Prishtinë, më 18.6.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Lutfi Zharku, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Hykmete Bajrami, Glauk Konjufca, Memli Krasniqi dhe Duda Balje, anëtarë.

I ftuar: Arsim Janova, u.d. i kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Arsim Janova- ZRRE; Izet Rushiti- ZRRE; Petrit Pepaj- ZRRE; Besim ... - ZRRE; Shpëtim Haziri- GP LDK; Vatra Qehaja- LVV; Marigona Bajrami- PSD; Liridon Gashi- SEEF; Dardan Abazi- – INDEP; Jetmir Bakia- D+ dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, si dhe praktikanti Afrim Berisha.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11.6.2019;
- 3.Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime;
- 4.Shqyrtimi i raportit vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, për vitin 2018;
- 5.Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.6.2019

Procesverbali i mbledhjes së datës 11.6.2019, u miratua pa vërejte

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime

Kryetarja, në cilësinë e kryesueses të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime, tha se grupi punues ka zhvilluar shumë aktivitete gjatë mbikëqyrjes dhe ka realizuar një vizitë pune në shtetin e Kroacisë, për t'u njohur me përvojat e zbatimit të Ligjit për shërbime. Si grup, kemi nxjerrë 8 rekomandime të sakta dhe të qarta, ku i rekomandojmë çdo institucioni, veç e veç, për të kryer obligimet që dalin nga Ligji për shërbime. Po ashtu, njoftoi komisionin se për këtë monitorim e ka mbështetur me ekspertizë OJQ DPLUS, të cilët i falënderoi për analizën e bërë enkas për grupin e punës. Pastaj i prezantoi rekomandimet si vijon:

Rekomandime

Qeveria e Republikës së Kosovës, obligohet që:

a) Të ndryshojë dhe të plotësojë Ligjin për shërbime, sa i përket pikës së vetme të kontaktit, si dhe në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të koordinojë ministrinë përgjegjëse dhe të përpilojë një plan për harmonizimin e legjislacionit me Ligjin për shërbime (shih pika 15 e këtij raporti);

b) Të koordinojë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me Ministrinë e Administratës Publike, që brenda 12 muajve nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të funksionalizojë pikën e vetme të kontaktit për shërbime afariste ose në kuadër të portalit E-Kosova ose në një portal tjetër dhe me kosto sa më të ulët dhe efektive; 2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, obligohet që:

a) Në afat prej 3 (tre) muajve nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të përpilojë një listë të saktë të të gjitha shërbimeve afariste që mbulohen nga ky ligj, sipas fushave të ndryshme dhe listën e detajuar të shërbimeve që përjashtohen nga ky ligj dhe të shpërndahet tek odat ekonomike, ministrinë dhe komunat, si dhe të publikohet në faqen e MTI-së, derisa PVK-ja të jetë gati;

b) Të fillojë koordinimin me odat ekonomike të ndryshme dhe komunat, për të marrë sugjerimet e tyre për përmbajtjen e PVK-së, duke marrë për bazë kërkesat e ofruesve të shërbimeve, si dhe të koordinohet me organizatat e konsumatorëve, për të marrë sugjerimet për kërkesat e përfituesve të shërbimeve;

c) Në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të përfundojë konsultimet me ministrinë e linjës, që kanë autoritet mbikëqyrës, rregullues apo tjetër, si dhe komunat e Kosovës, për t'i identifikuar shërbimet që do të duhej të përfshihen në listën e shërbimeve, mbledh procedurat dhe materialin për PVK, që u nevojitet ofruesve të shërbimeve dhe përfituesve të shërbimeve dhe të informojë për kyçjen e tyre në PVK;

- d) Të përgatisë dhe të ndërmarrë një fushatë vetëdijesuese për ofertuesit dhe përfituesit e shërbimeve për t'i informuar për obligimet e Ligjit dhe pikën e vetme të kontaktit;
- e) Të gjejë fonde apo të alokojë buxhet të ministrisë për themelimin dhe funksionalizimin e integritit të databazave ekzistuese të ministrive dhe komunave, për të funksionalizuar PVK-në për shërbime afariste;
- f) Brenda 6 (gjashtë) muajve nga miratimi i këtyre rekomandimeve, të përfundojë procesin e thjeshtimit të procedurave të ofrimit të shërbimeve afariste nga ministrinë e linjës dhe komunat e Kosovës.

Pas diskutimeve, komisioni nxori unanimisht këtë:

Përfundim

Miratohet raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, për vitin 2018

Kryetarja theksoi se për sot e kemi në shqyrtim raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2018 dhe për ta prezantuar këtë raport i kemi ftuar përfaqësuesit e ZRRE-së. Për prezantimin e raportit, kryetarja ia dha fjalën z. Arsim Janova, u.d. i kryesuesit të Bordit të ZRRE-së.

Arsim Janova (ZRRE), tha se raporti vjetor i punës së ZRRE-së, për vitin 2018, është gjithëpërfshirës. Përmban punët, aktivitetet dhe të arriturat e ZRRE-së, në kuadër të fushëveprimit të saj, Raportin financiar për vitin 2018, analizat dhe aktivitetet në sektorin e energjisë. Bordi i Rregullatorit nga marsi i vitit 2018, pas një periudhe gati njëvjeçare, është bërë funksional, duke u plotësuar edhe me dy anëtarë të tjerë nga Kuvendi i Kosovës. Bordi gjatë vitit 2018 ka mbajtur 10 mbledhje, në të cilat janë marrë 165 vendime, që kanë të bëjnë me miratimin e rregullave, metodologjive dhe dokumenteve të tjera të sektorit të energjisë, rregullimin e çmimeve të energjisë, monitorimin e tregut, licencimin e aktiviteteve të energjisë, autorizimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë nga Burimet e ripërtëritshme, mbrojtjen e konsumatorëve, etj. Gjatë vitit 2018 Bordi ka miratuar akte të reja rregullative apo ka amendamentuar: 4 rregulla, 6 kode dhe 2 procedura që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë. Gjatë vitit 2018 për marrje të licences pas ndërtimit të kapaciteteve përmes procedurës së autorizimit kanë aplikuar 4 ndërmarrje (njëres prej tyre i është lëshuar licenca me afat të gjatë kurse për tri të tjerat janë në proces të vlerësimit). Për vazhdim të licencës ka aplikuar Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) – TC “Kosova A” dhe i është vazhduar licenca për një vit. Gjatë vitit raportues për furnizim me energji elektrike janë licencuar 4 subjekte juridike, respektivisht kompani. Aktualisht, janë të licencuar gjithsej 8 furnizues. Përkundër këtij numri të të licencuarve për furnizim me energji elektrike, përveç KESCO-s, furnizuesit tjerë ende nuk janë aktivë në treg, që e bën të vështirë procesin e hapjes së mëtejshëm të tregut të energjisë. Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur aplikacione të reja për licencim të aktiviteteve të reja për furnizim (tregtim), me shumicë të energjisë elektrike. Ka pasur vetëm dy kërkesa për vazhdim të afatit për licencim, të cilave u është vazhduar afati i licencimit dhe një kërkesë për ndërprerje të licences, të cilës i është miratuar kërkesa dhe i është ndërprerë licenca. ZRRE bën

monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve në sektorin e energjisë. Në nëntor të vitit 2018 ka formuar grupe të veçanta për monitorim të ndërmarrjeve të energjisë, që kanë të bëjnë me: Programin e pajtueshmërisë të OSSH (KEDS-it) për vitin 2018; investimet kapitale të KOSTT-it dhe KEDS-it; furnizimin me energji dhe mbrojtjen e konsumatorëve; tregun e energjisë; ndërprerjet e energjisë; realizimin e projekteve të KELKOS-it. Raportet e monitorimit janë përfunduar dhe pas shqyrtimit nga Bordi këto raporte do të publikohen në faqen zyrtare të ZRRE-së. Gjatë vitit 2018, ZRRE ka lëshuar 6 autorizime finale dhe 13 autorizime preleminare (prej të cilave 12 aplikacione janë kualifikuar në pritje dhe 1 brenda caqeve) për ndërtim të kapaciteteve të reja për gjenerim të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Aktualisht, në total, me autorizime finale, janë në operim 12 gjeneratorë, me kapacitet 72.1 MW, në proces të ndërtimit janë 23 gjeneratorë, me kapacitet 182 MW. Me autorizime preleminare, në proces të autorizimeve finale, janë 3 gjeneratorë, me kapacitet 14.3 MW. Me autorizime preleminare, me status në pritje, janë 28 gjeneratorë, me kapacitet 295 MW. Në proces të shqyrtimit janë 14 aplikacione, me kapacitet 28.5 MW. Gjatë këtij viti raportues, ZRRE ka lëshuar 3 vendime për ndërtim të kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike për vetë-konsum, në total 254.2kV. Çrregullimi i çmimeve të energjisë së KEK-ut është bërë në fillim të vitit 2017. Po ashtu, hapja e tregut të energjisë elektrike ka filluar në fillim të vitit 2017, me daljen e konsumatorëve të nivelit të tensionit 220kV dhe 110kV në treg me çmime të parregulluara të furnizimit me energji elektrike, që përbënë rreth 8% të kërkesës për energji. Ka ngecje në procesin e hpjes së tregut për konsumatorët e kyçur në nivele më të ulëta të tensionit për arsyet të cilat janë diskutuar me ju në fund të muajit mars të këtij viti. Gjatë vitit 2018 Rregullatori ka përfunduar “Shqyrtimin e Dytë Rregullativ” për periudhën rregullative 1 prill 2018 – 31 mars 2023, për të përcaktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale të licencuarve: Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Sistemit të Tregut (OST/OT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes(OSSH- KEDS) dhe për periudhë njëvjeqare për Furnizuesim me Shërbim Universal (FSHU KESCO) si dhe të licencuarve në sektorin e energjisë termike. Në këtë shqyrtim tarifor shumvjeqar, Rregullatori ka analizuar të dhënat për pesë vitet e kaluara (2013 – 2017) dhe parashikimin për pes vitet e ardhëshme (2018 – 2022). Në shtator të vitit 2018, Bordi ka marrë vendimin preleminar për certifikimin e KOSTT-it. Posaçërisht certifikimi vërteton funksionimin e plotë të KOSTT-it, në përputhje me Direktivat e BE-së për Energjinë, brenda territorit të Republikës së Kosovës. Rregullatori gjatë vitit 2018 ka regjistruar 105 ankesa të konsumatorëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre kundër përgjigjeve të lëshuara nga ana e Furnizuesit dhe 1 kontest mes dy të licencuarve (ndërmarrjeve energjetike), e që gjithsej gjatë vitit 2018 janë regjistruar 106 ankesa/konteste. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2018, Rregullatori ka zgjidhur 223 ankesa të konsumatorëve, ku përfshihen edhe ankesat të cilat janë kthyer për rishqyrtim tek furnizuesi dhe operatori i sistemit të shpërndarjes. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të zgjidhura, 136 prej tyre janë vendosur në favor të konsumatorëve apo shprehur në përqindje 61.26 %, ndërsa 86 ankesa të konsumatorëve apo 38.74 % janë refuzuar si të pabaza. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2018 ka qenë 5,311 GWh, prej të cilave 5,008 GWh janë nga termocentralet, ndërsa nga HC dhe BRE tjera janë 303 GWh, dhe ka një ngritje të lehtë krahasuar me prodhimin në vitin 2017. Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm 1.39%, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta. Humbjet teknike arrijnë vlerën 13.17%, kurse konsumi i paautorizuar i energjisë (më tutje në tekst, humbjet komerciale) përbëjnë 14.75% të kërkesës në shpërndarje, prej të cilës energjia e pafaturuar në pjesën veriore të Kosovës, përbën 5.31% (272 GWh).Sa i përket sektorit të energjisë termike, gjatë vitit 2018, situata mbetet kryesisht e pandryshuar. Projekti i

kogjenerimit në NQ “Termokos” ka dhënë rezultate të mira, duke ngritur cilësinë e ngrohjes për konsumatorët e kyçur në rrjet. Ndërsa, projekti i kogjenerimit në NQ “Gjakova” është në proces të realizimit. Rregullatori financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe gjatë vitit 2018 ka realizuar të hyra në shumë prej 1,217,435.60 €, ndërsa ka shpenzuar 648,074.62 € dhe pjesa e pashpenzuar në shumë prej 569,360.98 € janë derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Nga Zyra Kombëtare e Auditimit është bërë auditimi i pasqyrave financiare, menaxhimi financiar dhe kontrolli për vitin 2018. Opinioni i auditorit të përgjithshëm është opinion i pamodifikuar, që do të thotë se pasqyrat financiare vjetore, për vitin 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik.

Liburn Aliu, tha se problemi i parë te ky raport është se mungojnë të dhënat e monitorimit dhe raportimi pa këto të dhëna është i cekët, prandaj raportimi është i mangët, pa këto të dhëna të monitorimit. Kisha sugjeruar që miratimin e këtij raporti ta bëjmë pasi që të na vijnë ato të dhëna. Po ashtu, kam edhe disa pyetje: Cila është diferenca e të hyrave në KEDS dhe sa janë humbjet në raport me vitin 2017? Sa keni ulje të humbjeve në vitin 2018? A keni monitorim apo vetëm në bazë të deklarimit të KEDS-it? Çka po ndodh me faturat në ato komuna, të cilat nuk paguajnë? Si është çështja e realizimit të kontratave nga KEDS-i për investimet e detyrueshme për vitin 2018? Kush, konkretisht i monitoron investimet e ZRRE-së dhe sa zyrtarë janë të përfshirë në këtë monitorim? Te pjesa e “Kosovës së Re”, konsideroj që duhet një analizë e thellë, sa i përket çmimit, mënyrës dhe pasojave që mund t’i ketë, duke futur edhe elementin që do të zgjasë në kohë, pastaj neve na mbetet ndërtesa dhe do të paguajmë ekstra për tregtim të CO2. A jeni interesuar për kërkesat e rasteve individuale për t’u kyçur në rrjet? Është e vështirë për nga procedura të kyçen në rrjet kompanitë e vogla apo kompanitë private që do të mund të prodhonin energji të ripërtëritshme dhe të kyçeshin në rrjet, ndërsa ato që po licencohen, jemi duke e parë nga viti në vit, një situatë të monopolizimit e që vërehet qartë edhe në raport p.sh. në etapën 1 dhe etapën 2, 85% të licencave për prodhimin e energjisë solare e merr një prodhues, pra shkon te “Devulli grup”. Për mua, kjo është një ndër problemet kryesore të punës tuaj dhe mendoj që kjo do të duhej të hetohej shumë më thellë. Pas takimeve me ministrin e mjedisit, ku është diskutuar çështja e hidrocentralit, pra është kompania “KELKOS”, e cila vazhdon operimin pa licencë në hidrocentralin e Deçanit. Sipas ministrisë, shkelja e ligjit po ndodh nga ana e ZRRE-së. Pse po e lejoni e nuk po e ndalni? Si i koordinoni punët me ministrinë e mjedisit, pra a keni mekanizëm, i cili monitoron licencat që ju i jepni?

Dardan Sejdiu, pyeti: Çka është “NKEC”, pastaj obligimi i shërbimit publik, a mund të më tregoni për kë është dhe cili është qëllimi i këtij instrumenti? Gjithashtu, dua ta di, a ka pasur ndonjë palë kontraktuale të Kosovës apo institucion të huaj, me të cilin ne jemi në marrëveshje kontraktuale për energji që ka dërguar, komente, interesim, pyetje, bregnga, shqetësim në lidhje me obligimin e shërbimit publik? Nëse po, kisha kërkuar që ky raport të plotësohet me pyetjet e tyre dhe përgjigjet e juaja, në mënyrë që të shohim qartë se për çfarë relacionesh po flasim, sa i përket obligimit të shërbimit publik dhe a kemi ndonjë shkelje të marrëveshjeve kontraktuale mbi Ligjin për energjinë. Te burimet e ripërtëritshme, a ka ndonjë diskutim në lidhje me licencat për energjinë e prodhuar nga uji, sepse kapacitetet janë të përcaktuara? sa i përket hidros, me çfarë modeli dhe si do ta trajtoni shpërndarjen e këtyre kapaciteteve në industri? Metoda dhe modeli i ankandit, a po konsiderohet nga ZRRE-ja si metodë për uljen e tarifave që po i paguajmë për burimet e ripërtëritshme? Sa është ZRRE-ja e involvuar në procesin e

përzgjedhjes së operatorit për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” dhe për çfarë teknologjie është fjala? Roli i ZRRE-së nuk duhet të jetë vetëm vëzhgues, por u shoh si mbrojtës të interesit publik, në kuadër të një strategji të zhvillimit të sektorit energjetik.

Arsim Janova (ZRRE), tha se po filloj me raportin e monitorimit. Ne, në nëntor, i kemi formuar grupet e monitorimit dhe monitorimi është duke ndodhur në vazhdimësi sipas ligjit. Raportet janë kompletuar dhe në mbledhjen e parë që do ta kemi, si bord, do t’i shqyrtojmë do t’i miratojmë, si dhe do t’i publikojmë. Po ashtu, do t’ua dërgojmë edhe juve si komision. Për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), caqet i përcakton Qeveria, respektivisht MZHE-ja, para 4 vitesh i ka përcaktuar caqet e BRE-ve për ujë, erë, për biomasë dhe për solar. Në bazë të ligjit në fuqi, ne shkojmë sipas procedurës së autorizimit, që i bie kush i pari i kompletion dokumentet, atij i jepet autorizimi për ndërtim, mirëpo ne kemi pasur aty rol më shumë teknik. Ligji nuk e ka ndaluar që një pronar, jo vetëm për solare, por edhe për hidro që një pronar të ketë disa hidrocentrale, maksimumi është deri në 10 dhe është procedurë që kush aplikon i pari, procedurë kjo e përcaktuar para 4 viteve për BRE-të. Sa i përket se sa ka reagime të institucioneve përkatëse për palët kontraktuese, sa i përket termocentralit “Kosova e Re”, ka vërejtje që i japin, sa i përket termocentralit “Kosova e Re” ndërsa sa i përket komunitetit të energjisë, kemi vërejtje edhe ne. Ne kemi gjeneratorë për vetëkonsum dhe kemi një rregull që kemi nxjerrë në vitin 2017 dhe kemi filluar ta aplikojmë atë rregull, në të cilën parashihet vetëm për konsumatorët që janë të kyçur në tension të ulët, në 04 dhe deri në 100KV. Kemi pasur reagime nga kompanitë publike, pse nuk po lejohet edhe për ato kompani. Ne kemi futur në amandamentim atë rregull dhe jemi në proces të ndryshimeve. Kërkesat e bizneseve janë që ato të lejohen edhe për bizneset e mëdha në kapacitete shumë të larta. Ne jemi duke i shqyrtuar këto kërkesa dhe do të tentojmë t’i fusim në amandamentimin e rregullores dhe patjetër kjo rregullore, para se të miratohet, do të kalojë në dëgjim publik, në mënyrë që të nxjerrim më të mirën për këto kategori të konsumatorëve. Për hidrocentralet e KELKOSIT, është e vërtetë që i ka ndërtuar 3 hidrocentrale, me 3 gjeneratorë në Deçan, në Belaj dhe Lumbardhi 2. Në Lumbardhi 2, është i treti që është ndërtuar dhe atë e kemi ndaluar dhe e kemi shkyçur prej rrjetit, sepse ka pasur disa devijime, përkundër që ka pasur një leje ndërtimore dhe ne kemi kërkuar sqarim prej ministrisë, që janë përgjigjur duke thënë se tani as dy hidrocentralet e para nuk janë në gjendje të rregullt. Ne i kemi dhënë autorizimet me projekte të ndara, ndërsa ata i kanë dhënë për 3 projekte lejet ujore dhe lejet mjedisore, ndërsa sa i përket Belajt dhe Deçanit, ata i kanë të gjitha në rregull, dhe lejen ndërtimore, por nuk e kanë lejen mjedisore. Pra, kur kanë filluar të operojnë, ministria na ka thënë që tash do të lëshojmë lejen dhe ata kanë filluar të operojnë, por tani ministria nuk po i lëshon ato dokumente dhe ne u kemi dhënë edhe 3 muaj afat dhe kanë afat deri më datën 28 qershor 2019. Pra, nëse nuk na i sjellin dokumentet, ne do t’i shkyçim, mirëpo ata operojnë tashmë më shumë se një vit.

Kryetarja pyeti: Meqë jemi te diskutimi për Lumbardhin, që ka pasur disa devijime, a mund të më sqaronni se për çfarë devijimesh bëhet fjalë, që ta kemi më të qartë?

Arsim Janova (ZRRE), tha se në lejen ndërtimore që e kanë pasur, ka pasur devijim të ndërtimit atje dhe e kemi ndaluar, e kemi shkyçur tash e disa muaj.

Petrit Pepaj (ZRRE), tha se në raport i kemi paraqitur humbjet gjatë viteve 2008 – 2018, se sa është zvogëlimi i humbjeve vit pas viti, dhe nëse e krahasojmë vitin 2017 me vitin 2018,

humbjet janë zvogëluar për 29.3% dhe ne për çdo vit raportojmë në periudha të caktuara për nivelin e humbjeve. Ndërsa, sa i përket gjendjes në katër komunat e veriut, gjendje është më e mirë, mirëpo është ende e vështirë, përderisa nuk krijohet një infrastrukturë e shtetit dhe të bëhet respektimi i marrëveshjeve që Kosova i ka nënshkruar me Serbinë.

Arsim Janova (ZRRE), tha se sa i përket pyetjes se çka është NKEC, NKEC është një ndërmarrje publike, që e ka themeluar Qeveria e Kosovës, e cila e blen energjinë prej Kosovës së Re dhe ia shet furnizuesit, ky është roli i saj.

Dardan Sejdiu, pyeti: A e blen NKEC komplet energjinë që në të ardhmen e prodhon “Kosova e Re” dhe pasi që e blen, ku e dërgon?

Arsim Janova (ZRRE), tha se NKEC e blen krejt energjinë nga “Kosova e Re” dhe ua shet furnizuesve me pakicë.

Dardan Sejdiu, pyeti: “Contour Global”, në zinxhirin e sektorit energjetik, është prodhues siç janë gjeneratorët e KEK-ut dhe tash NKEC, do ta blejë rrymën prej kompanisë “Contour Global” me një çmim të përcaktuar në kontratë, përafërsisht 80 euro. A ka mundësi të më tregoni se sa është çmimi sot që e blen KEDS-i rrymën prej prodhuesit që prodhon rrymë sot në Kosovë? A ka mundësi të më tregoni se çka bën NKEC në tregun energjetik sot apo vetëm shpenzojnë para për paga deri në vitin 2023?

Arsim Janova (ZRRE), tha se çmimi mesatar është 31 euro për megavat për energji elektrike.

Liburn Aliu, pyeti: Sa është çmimi i importit?

Arsim Janova (ZRRE) çmimi i importit është 66 euro.

Dardan Sejdiu, pyeti: Nëse supozojmë që ka diferencë dhe dallim në mes të çmimit, të cilin e blejmë prej NKEC, prej “Contour Global”, në treg, në import është ky çmim. KEK-u e shet me një çmim edhe më të ulët dhe ne e blejmë me 80 euro, prej nga e financon NKEC këtë diferencë?

Liburn Aliu, tha se termocentralet tona e përdorin qymyrin, i cili ka kapacitete. Ne do të detyrohemi ta bëjmë një fabrikë, e cila do të bëjë përpunimin e qymyrit, për t’ia dhënë kompanisë “Contour Global”, e cila do të jetë 300 milionë euro. Kjo fabrikë mos t’i japë 9 kJ apo sa ata kanë nevojë, ne do t’ua paguajmë, a është kjo e vërtetë?

Arsim Janova (ZRRE), tha se diferencën sigurisht që e paguan konsumatori. Dua të shtoj edhe diçka. Kur flasim për çmimin e KEK-ut, duhet të kuptojmë që po flasim për një aset që ka tejkaluar çdo jetëgjatësi edhe teknike, edhe ekonomike. Çmimi i KEK-ut duhet të rritet, që të investohet në njësinë e Kosovës B, që të vijmë në parametrat e duhur ambiental, në mënyrë që të funksionojmë sipas direktivave të Komisionit Evropian. Obligimi i shërbimit publik është një taksë, e cila do t’i vendoset secilit furnizues për operimin dhe prodhimin e kapacitetit të energjisë dhe do të jetë në mënyrë të barabartë.

Dardan Sejdiu, tha se logjika e BRE-së, se kush vjen i pari, atij i japim shërbim të parit, unë besoj që ka një problem ekonomik, sepse kjo varet se kush e ka informacionin i pari. Unë më shumë jam që këtë ta bëjmë me ankand, dhe e dyta, është shumë me rëndësi, ju lutem, raportet e monitorimit.

Liburn Aliu, ju thatë se kush vjen i pari, i shërbehet. Nëse e shikojmë etapën e parë, një kompani apo një pronar ka 6 megavat, çmimi për megavat është 134 euro. Në etapën e dytë, ky çmim ka rënë në 90 euro dhe në etapën e dytë 85% të tregut e merr një pronar ky pronar është “Devolli”, i cili e merr me 6 kompani të ndryshme dhe kjo është për 12 vjet. Pra, për 12 vjetët e ardhshme, ju do të paguani me këtë çmim, prandaj kjo nuk është në rregull që vetëm një kompani t’ia japim krejt dhe mos t’i zhvillojmë kompanitë tjera të vogla. Kjo tregon që shteti ynë nuk është shtet në shërbim të zhvillimit.

Arsim Janova (ZRRE), tha se sa i përket raportit të monitorimit, pasi që të miratohet, ne do t’ia dërgojmë një kopje edhe komisionit. Ne nuk merremi me politika, ne vetëm e zbatojmë udhëzimin e ministrisë. Në aspektin procedural dhe ligjor nuk ka asnjë shkelje dhe këtu fitojnë leje për operim ata që kanë mundësi të investojnë dhe të zhvillojnë vendin.

Kryetarja, në bazë të diskutimit që u bë, mund të vijmë deri te një përfundim, që deputetët të kërkojnë raport shtesë për çështjet që u ngritën këtu dhe besoj që ju, si ZRRE, i keni evidentuar të gjitha kërkesat e deputetëve, që iu duhen informacione shtesë dhe ne presim që t’i sillni ato raporte, me informacione më të detajuara

Pas diskutimeve, komisioni nxori unanimisht këtë:

Konkluzion

Zyra e Rregullatorit të Energjisë të dërgojë raport shtesë, lidhur me çështjet e ngritura nga komisioni.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA